

  
**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR**  
**TIRANË**

Nr. 503 Regjistri Themeltar

Nr. 736/ 2 Vendimi

Date 24.02.2022 Regjistrimi

Date 28.03.2022 Vendimi

**VENDIM**

**PËR DEPOZITIM NË REGJISTRIN E FONDACIONIT**

Sot, me datë **28.03.2022** unë **Julian Haxhiu**, Gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, mora në shqyrtim kërkesën dhe aktet e paraqitura nga **Fondacioni "ALBANA"**, me kerkues **Ledjan Prifti**, i cili kërkoi depozitimin e **Vendimit Nr. 2, date 14.02.2022 të Bordit Drejtues të Fondacionit "ALBANA"**,

**KONSTATOVA**

Se Fondacioni **"ALBANA"**, është regjistruar, si organizatë jofitimprurëse në formën e Fondacionit me **Vendimin Nr. 736** datë 12.04.2019 me seli ne Tirane dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me statutin dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

**Bordi Drejtues i Fondacionit "ALBANA", me vendimin Nr. 2, date 14.02.2022 ka vendosur:**

Miratimin e dorëheqjes së znj. **Preveza Abrashi**, për largimin me vullnetin e saj nga detyra e drejtores ekzekutive të Fondacionit.

Miratimin e dorëheqjes së z. **Ledjan Prifti** për largimin me vullnetin e tij nga detyra e anëtarit të Bordit Drejtues.

Emerimin në detyrën e drejtorit ekzekutiv të Fondacionit të z. **Ledjan Prifti**, i del. 11.07.1981. lindur ne Pojan Fier dhe banues ne Tirane, me zotësi juridike dhe për të vepruar, shtetas shqiptar, mbajtës i dokumentit pasaportë biometrike me nr. B14350658 dhe numer personal 110711139A, i cili ngarkohet të ushtrorjë kompetencat sipas statutit të Fondacionit dhe Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse për një periudhë të pakufizuar.

Emërimin në detyrën e anëtarit të Bordit Drejtues të Fondacionit, të shtetasit:

**Agron Dalipaj**, i del. 30.08.1963, lindur në Këlcyre, dhe banues ne Pogradec, në adresë **Rruga Violeta Manushi, nr. 06**, shtetas shqiptar, mbajtës i Letërnjoftimit (ID) me nr. 036778487 dhe numër personal G30830129W, me zotësi juridike dhe për te vepruar- Anëtar Bordi

Zgjedhjen e z. **Bledar Dika** kryetar të Bordit Drejtues për një periudhë 2 vjeçare me të drejtë rizgjedhje.

Zgjerimin e qëllimit të veprimtarisë së Fondacionit edhe në fushën e:

Promovimin dhe mbrojtjen e te drejtave dhe lirive të njeriut, drejtësisë shoqërore, identitetit kombëtar dhe trashëgimisë kombëtare, nëpërmjet instrumentave ligjorë kushtetues dhe ushtrimit të te drejtave të shoqërisë civile.

Ndjekjen e rasteve që përbëjnë shkelje flagrante të këtyre të drejtave pranë çdo organi ekzekutiv qendror apo vendor, pushtetit legjislativ, pushtetit gjyqësor, pranë Gjykatës Kushtetuese si edhe pranë çdo institucioni ndërkombëtar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe Gjykatave ndërkombëtare të mbrojtjes së te drejtave të njeriut.

Mbrojtjen pranë Gjykatës Kushtetuese të drejtave themelore kushtetuese të individëve si edhe çdo subjekti juridik, kur këto të drejta cenohen nga ligje të ndryshme, për gjykimin si antikushtetues të këtyre normave të cilat cénojnë drejtpërsedrejti edhe fondacionin në misionin e tij civil duke ushtruar të drejtën për të qenë palë në to.

Shtimin në nenin 11 të Statutit të paragrafit:

Bordi Këshillimor është organ këshillimi, përbërja numerike e te cilit është e ndryshueshme në varësi të nevojave të Fondacionit, por në asnjë rast me pak se 3 anëtare. Anëtarët e Bordit Këshillimor emërohen nga Bordi Drejtues me shumicë të thjeshte votash për një afat 1 vjeçar. Anëtarit e Bordit Këshillimor Bordin Drejtues vetëm për çështje për të cilat kërkohet shprehimisht opinioni i tyre. Anëtarët e Bordit Këshillimor mund të shkarkohen përpara afatit me shumicën e thjeshtë të Bardit Drejtues, në rast të mospjesëmarrje në mbledhje dhe mospërbushjes së detyrave për të cilin ata janë ngarkuar.

Ndryshimin e nenit 7 të Aktit të Themelimit dhe nenit 10 të statutit si vijon: Bordi Drejtues perbehet nga 3 (tre) anëtarë.

Anëtarë të Bordit Drejtues janë:

*Bledar Dika, i dtl. 13.03.1985, lindur në Elbasan dhe banues në Tiranë në adresë Rruga "Lidhja e Priz-renit", pallati 2, hyrja 5, me shtetësi shqiptare, me zotësi juridike dhe për të vepruar, mbajtës i dokumentit pasaportë me nr. BE4842074 dhe numër personal 150313087P Kryetar i Bordit.*

*Arneta Çuçi (Furriku), e dtl. 31.08.1996, lindur në Pogradec dhe banuese në Tiranë, në adresë, Rruga "Panajot Pano", nd. 11, hyrja 9, ap. 5, Yzberisht, Kashar, me shtetësi shqiptare, me zotësi juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e dokumentit letërnjoftim (ID) me nr. 037846022 dhe numër personal J65831062 Anëtare e Bordit*

*Agron Dalipaj, i dtl. 30.08.1963, lindur në Kelcyre, dhe banues në Pogradec, në adresë Rruga Violet Manushi, nr. 06, shtetas shqiptar, mbajtësi Letërnjoftimit (ID) me nr. 036778487 dhe numer personal G30830129W, me zotësi juridike dhe për të vepruar Anetar Bordi.*

Kryetari i Bordit, ushtron këtë detyrë për një periudhë 2 vjeçare me te drejte ripërteritje. Ai drejton mbledhjet e Bordit Drejtues dhe e përfaqëson atë në aktivitete të ndryshme. Kryetari i Bordit emërohet dhe shkarkohet nga vete Bardi me shumice të thjeshtë. Bordi Drejtues e shkarkon kryetarin e bordit për shkaqet që shkarkohet çdo anëtar i Bordit. Anëtarët e bordit ushtrojnë kompetencat për një periudhë të pakufizuar. Anëtarët e Bordit emerohen, largohen apo shkarkohen nga vet Bordi. Anëtarët e Bordit e humbasin këtë cilësi në rastet kur: japin



doreheqjen, mbaron afati i emërimit të tyre sipas statutit shkarkohen për mospjesëmarrje në me shumë se 2 mbledhje, për shkelje të statutit apo mospërbushje të detyrimeve sipas ligjit dhe statutit kur çenohet integriteti moral dhe social i tij kur është subjekt një procedimi apo vendimi penal.

Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit është z. Ledjan Prifti, i del. 11.07.1981, lindur në Pojan, Fier dhe banues në Tiranë, me zotësi juridike dhe për të vepruar, shtetas shqiptar, mbajtës i dokumentit pasaportë biometrike me nr. B14350658 dhe numër personal I10711139A, i cili do të ushtroje detyrat sipas statutit dhe Ligjit nr. 8788 datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse për një periudhë të pakufizuar.

Ndryshimin e nenit 4 të Aktit të Themelimit dhe nenit 2 të Statutit të Fondacionit si më poshtë:

Qellimi i fondacionit është:

- 1. Studimi dhe aktualizimi i rrymave kulturore të traditës së Rilindjes Kombëtare nga fillesat deri me sot, ruajta, mbështetja dhe promovimi i vlerave të Rilindjes dhe trashëgimisë së saj kulturore e politike dhe kombëtarizmit shqiptar. 2. Nxitja dhe zhvillimi i debatit rreth identitetit shqiptar për t'i dhënë substancë çdo qasjeje përfshirëse të Shqipërisë në organizmat ndërkombëtare. 3. Studimi dhe evidentimi profilit kulturor e politik të atdhetarizmit shqiptar, bazuar në principet e unitetit dhe solidaritetit kombëtar, sensit të shtetit e kombit. 4. Mbështetja dhe ndihma për gjithë organizmat e ruajtjes, mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore kombëtare dhe turizmit kulturor, me qëllim formimin, promovimin e përhapjen në Shqipëri e jashtë, të shprehjeve e paraqitjeve të kulturës, historisë, gjuhës dhe artit shqiptar. 5. Promovimi i politikave të modernizimit ekonomik e social të Shqipërisë për një rritje e zhvillim kombëtar të qëndrueshëm dhe për t'i dhënë shpresë brezave të rinj. 6. Ndihmesë për reflektimet rreth mardhenieve të reja ndërkombëtare e rreth ndryshimeve transformuese të politikës bashkëkohore, rreth krizës së përfaqësimit, rreth së ardhmes së Shtetit.*

Për qëllimet e veta Fondacioni mund të ndërmarrë të gjitha nismat që vlerësohen si të përshtatshme për të mundësuar jetësimin e tyre, konkretisht Fondacioni mund të:

- a) promovojë nisma kulturore e sociale, simpoziume, seminare, debate publike, prezantime librash, kurse formimi, çmime e bursa studimi*
- b) kryejë studime e kërkime dhe në bashkëpunim me subjekte të tjera në lidhje me kulturën ekonomike e politiken.*
- c) eksperimentojë forma të reja të pjesëmarrjes në jetën publike, zhvillimet sociale e historike.*
- d) realizojë publikime e produkte në shtypin tradicional, elektronik e multimedial.*
- e) paraqitjen e zhvillimin e të gjithë aktiviteteve, të çdo natyre publike, me synim përmbushjen e qëllimeve statutores.*

Promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, drejtësisë shoqërore, identitetit kombëtar dhe trashëgimisë kombëtare, nëpërmjet instrumentave ligjorë kushtetues dhe ushtrimit të të drejtave të shoqërisë civile.

Ndjekjen e rasteve që përbëjnë shkelje flagrante të këtyre të drejtave pranë çdo organi ekzekutiv qëndror apo vendor, pushtetit legjislativ, pushtetit gjyqësor, pranë Gjykatës Kushtetuese si edhe pranë çdo institucioni nderkombëtar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe Gjykatave ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Mbrojtjen pranë Gjykatës Kushtetuese të drejtave themelore kushtetuese të individëve si edhe çdo subjekti juridik, kur këto të drejta çënohen nga ligje të ndryshme, për gjykimin si antikushtetues të këtyre normave të cilat çënojnë drejtpërsdrejti edhe fondacionin në misionin e tij civil duke ushtruar të drejtën për të qenë palë në to.

Autorizohet z. Ledjan Prifti, me cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të Fondacionit të hartojë kërkesën drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për depozitimin e këtij vendimi pranë Zyrës së Regjistrimit të Organizatave Jofitimprurëse sipas Ligjit nr. 8788 datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse" i ndryshuar.

Vendimi i mësipërm është marrë në përputhje me statutin e Fondacionit si dhe në përputhje me Ligjin Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" i ndryshuar. Për sa më sipër, kërkesa e paraqitur është e mbështetur në aktet e fondacionit dhe në dispozitat ligjore dhe si e tillë duhet pranuar.

#### **PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të ligjit nr.8788, datë 07.05.2001 "*Për organizatat jofitimprurëse*" i ndryshuar me ligjin nr.9814, datë 04.10.2007 e ligjin nr.92/2013 si dhe në mbështetje të ligjit nr.8789, datë 07.05.2001 "*Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse*".

#### **VENDOSA**

Pranimin e kërkesës.

**Depozitimin e Vendimit Nr. 2 datë 14.02.2022 të Bordit Drejtues të Fondacionit "ALBANA".**

Urdhërohet Zyra e Regjistrimit e Organizatave Jofitimprurëse për pasqyrimin e ndryshimeve në kolonat përkatëse të regjistrit.

Datë 28.03.2022.

**GJYQTAR**  
**Julian HAXHIU**

